

VENDIM
Nr. 34, datë 10.2.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2025 PËR SHOQËRITË UJËSJELLËS-KANALIZIME TË LIDHURA NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV DHE SHOQËRITË UJËSJELLËS-KANALIZIME TË LIDHURA NË NIVELET E TENSIONIT 20/10/6 kV, TË CILAT FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.2.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 722/1 prot., datë 10.2.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2025 dhe përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqëritë ujësjellës-kanalizime për vitin 2025”,

Konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 370 prot., datë 27.1.2025, protokolluar në ERE me nr. 722 prot., datë 29.1.2025, ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2025, për klientët FMF të lidhur në nivelet e tensionit 6/10/20 kV (klientë të rëndësishëm të veçantë), si dhe për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe 35 kV.

- Rezulton se shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve gëzojnë status të veçantë, të përcaktuar në pikën 1 të nenit 8 të VKM-së nr. 456/2022, e ndryshuar, si shoqëri të cilat sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve.

- Bashkëlidhur aplikimit rezulton gjithashtu dhe shkresa e shoqërisë KESH sh.a. me nr. 7349/1 prot., datë 31.12.2024, me lëndë “Për miratimin e tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a.”. Në këtë shkresë, KESH sh.a. ka paraqitur analizat për programin ekonomik-financiar të vitit 2025 dhe parashikimet për periudhën 2026–2029. Pas shqyrtimit, Këshilli Mbikëqyrës e ka miratuar këtë program me vendimin nr. 10121/1, datë 31.12.2024.

- Gjithashtu, është përcaktuar se çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për furnizimin e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në vitin 2025, për rrjetin me tension 35 kV dhe 20/10/6 kV, do të jetë 5.70 lekë/kWh.

- Bazuar në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që merren në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë:

- **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027 e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024, ‘Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027’ prej *0.85 lekë/kWh*.

- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelet e tensionit 20/10/6 kV**, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, vijon të jetë *3.99 lekë/kWh*.

- **Kostot administrative**, prej *1.06 lekë/kWh*.

- **Kthimi për riskun prej 3%** (i aplikuar mbi çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për energji elektrike) në vlerën *0.36 lekë/kWh* për kategorinë e klientëve të

lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe në vlerën *0.17 lekë/kWh* për kategorinë ujësjellës-kanalizime.

- Në zbatim të Metodologjisë si dhe bazuar në të dhënat e aplikimit të FSHU sh.a., çmimet e shitjes së energjisë elektrike për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë përlogaritur nga ERE si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime 2025			
Viti 2025		Nivelet e tensionit	
		35 kv	20/10/6 kv
		Njësia	Çmimi
ÇBET	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	5.7
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.17
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TR	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSH	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = ÇBET + Pr*ÇBET + TR + TSH + CA		Lekë/kWh	9.33
			11.77

- Bazuar në përcaktimet e metodologjisë respektive, elementet e formulës përlogaritëse si dhe të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë e ujësjellës-kanalizime për vitin 2025 do të jetë:

- 9.33 lekë/kWh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV;
 - 11.77 lekë/kWh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV;
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2025, prej 9.33 lekë/kWh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2025, prej 11.77 lekë/kWh për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.

3. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti